



ILD NDERON PROCESIN DISIPLINOR MBI NJË SHEKULLOR NË SHQIPËRI

Faqe 2-4

“

Inspektimi gjyqësor mbetet shpesh në hije dhe vëmendjen publike e marrin natyrshëm vendimet gjyqësore. Por, inspektimi gjyqësor mbetet një mjet shumë i rëndësishëm për ruajtjen e integritetit të sistemit të drejtësisë. Duke patur parasysh këtë, por edhe mundësitë reale, që ILD të prodhonte një dokumentim historik, të të gjithë ecurisë e shërbimit të inspektimit gjyqësor në Shqipëri, që prej vitit 1912, sfida dukej gati e pakapërcyeshme.



ILD në shifra

141 vendime nga 276 praktika të trajtuara

- 121 vendime arkivimi pas shqyrtimit fillestar
- 20 vendime arkivimi pas verifikimit

36 vendime verifikimi

2 vendime për mbyllje hetimi disiplinor për 2 magjistratë (1 gjyqtar, 1 prokuror)

Qytetari në Zyrën e ILD-së

Gjatë muajit Dhjetor 2025:

- janë pritur **31 ankues**, të cilët janë paraqitur në ambientet e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- janë realizuar **30 telefonata** me qytetarë, të cilët kanë kërkuar informacion mbi fazën e ankesave të tyre ose Informacion mbi plotësimin e formularit TIP të ankesës.
- janë trajtuar **14 kërkesa** për informacion.



Fjala përshëndetëse e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë Fq. 5-7



Metani: Një drejtësi e fortë dhe e qëndrueshme kërkon angazhim të vazhdueshëm Fq. 8-10



Inspektori i Lartë i Drejtësisë, vizitë pune në Hungari Fq. 11



ILD mori pjesë në Asamblenë e Përgjithshme të RESIJ Fq. 12

ILD NDERON PROCESIN DISIPLINOR MBI NJË SHEKULLOR NË SHQIPËRI



Inspektori i Lartë i Drejtësisë organizoi një pasdite pune mbi inspektimin disiplinor në Shqipëri. I konceptuar si një moment reflektimi për vlerat dhe kontributin ndër vite të inspektimit disiplinor të magjistratëve dhe njerëzve që kanë punuar aty, në aktivitet u shfaq dokumentari televiziv, “Të inspektosh drejtësinë”, përgatitur si një historik i zhvillimeve të inspektimit disiplinor prej viteve 90-të e deri në ditët e sotme.

Historiku i procesit disiplinor ndaj magjistratëve, që daton me shpalljen e pavarësisë në vitin 1912, u soll përmes një botimi të posaçëm të përgatitur nga Prof. Erind Mërkuri “Historik i përgjithshëm i procesit disiplinor ndaj magjistratëve në Shqipëri (1912 – 2025)”, si një dokumentim i përpjekjeve të hershme të vendit tonë për ta mbajtur sistemin e drejtësisë të përgjegjshëm.

Aktiviteti bëri bashkë drejtues e përfaqësues të institucioneve të drejtësisë në vend, të gjykatave e zyrave të prokurorive, kontributorë të shërbimit të inspektimit ndër vite, akademikë e studiues.

Në fjalën e tij përshëndetëse Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. Metani evidentoi se megjithëse prej mbi 5 vitesh vendi ka një institucion të vetëm,

që merret me inspektimin e gjyqtarëve e prokurorëve, ky proces nuk ka lindur me ILD-në në vitin 2020, por shenjohej shumë më herët në historinë e tonë, që me themelimin e shtetit shqiptar dhe bëhet fjalë për një kontribut shumë të rëndësishëm mbi një shekullor, që Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë synon ta sjellë të dokumentuar.

“Kur me kolegët në zyrën e ILD, menduam dhe diskutuam idenë e rrugëtimit të shërbimit të inspektimit gjyqësor dhe atij të prokurorisë në Shqipëri, ishim shumë entuziastë, por edhe pasigurt, nëse do të arrinim të tregonim gjerësisht zhvillimin e inspektimit të magjistratëve në Shqipëri. Inspektimi gjyqësor mbetet shpesh në hije dhe vëmendjen publike e marrin natyrshëm vendimet gjyqësore. Por, inspektimi gjyqësor mbetet një mjet shumë i rëndësishëm për ruajtjen e integritetit të sistemit të drejtësisë. Duke patur parasysh këtë, por edhe mundësitë reale, që ILD të prodhonte një dokumentim historik, të të gjithë ecurisë e shërbimit të inspektimit gjyqësor në Shqipëri, që prej vitit 1912, sfida dukej gati e pakapërcyeshme. Por me sa duket, ia dolëm. Sot, do hapim perden e kësaj pjese vitale dhe emocionuese të historisë sonë. Materialet që botohen në këtë libër përbëjnë një pjesë shumë të rëndësishme nga tradita institucionale e drejtësisë shqiptare.”





Duke u ndalur tek veprimtaria në këto vite e ILD-së, z. Metani veçoi sfidën e drejtimit të një institucioni të ri, me vendosjen e praktikave e standardeve të punës për t'i qëndruar kohës.

“Zgjedhja në detyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë erdhi me përgjegjësinë e jashtëzakonshme, për përballjen me ngritjen e një institucioni të tillë me themele të forta profesionale, me pritshmëritë e publikut dhe aktorëve të tjerë politikë e institucionalë dhe me pritshmëritë e vetë sistemit të drejtësisë. Duke mos patur model paraardhës, vendosja e standardeve të tilla dhe mbi të gjitha, ruajtja e ekuilibrit mes pavarësisë së magjistratëve dhe interesit krejt legjitim të publikut për mënyrën se si administrohet drejtësia, ishte dhe mbetet busulla orientuese e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Kjo mbetet sfida më e madhe profesionale dhe personale e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, jo për stabilitet institucional, por duke e parë këtë balancë interesash, si një parim kushtetues të rëndësishëm për të ardhmen e sistemit të drejtësisë dhe të shtetit të së drejtës. Natyrshëm si çdo proces, edhe testimi i kësaj filozofie pune,

kërkon periudhën e vet të përballjes me sfidat që kalon sistemi dhe koha do të tregojë qëndrueshmërinë e zbatimit të saj në praktikë, si dhe efektet afatgjata në sistem.”

Autori i botimit, Prof. Erind Mërkuri nënvizoi faktin se shërbimi disiplinor i magjistratëve ka një histori dhe traditë në vendin tonë. Përcjellja e saj sidomos në formë dokumentare është e rëndësishme sepse respektimi i traditës si nevojë e shtetbërjes është një thesar kulturor. Për ta ilustruar, ai solli një shprehje të Sir Roger Scruton, sipas të cilit “Jemi me fat që po ndërtojmë mbi arritjet e paraardhësve tanë dhe gjëja e rëndësishme është t'i ruajmë ato arritjet e të mos i hedhim tutje”.

Akademiku Shaban Sinani vlerësoi botimin si një nisëm shumë të rëndësishme që periodizon në mënyrë shkencore fazat në të cilat ka kaluar shërbimi disiplinor shqiptar në shekullin e fundit. Vlerë e veçantë e botimit, sipas akademikut është promovimi i trashëgimisë në një fushë jo shumë të promovuar.



FOTO NGA AKTIVITETI



FJALA PËRSHËNDETËSE E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË



Përsshendetje të gjithëve e mirë se erdhët!

Së pari, dëshiroj t'ju falenderoj të gjithëve, që gjetët kohë dhe erdhët në këtë takim. Për hir të së vërtetës, kur me kolegët në zyrën e ILD, menduam dhe diskutuam idenë e rrugëtimit të shërbimit të inspektimit gjyqësor dhe atij të prokurorisë në Shqipëri, ishim shumë entuziastë, por edhe pasigurt, nëse do të arrinim të tregonim gjerësisht zhvillimin e inspektimit të magjistratëve në Shqipëri. Inspektimi gjyqësor mbetet shpesh në hije dhe vëmendjen publike e marrin natyrshëm vendimet gjyqësore. Por, inspektimi gjyqësor mbetet një mjet shumë i rëndësishëm për ruajtjen e integritetit të sistemit të drejtësisë.

Duke patur parasysh këtë, por edhe mundësitë reale, që ILD të prodhonte një dokumentim historik, të të gjithë ecurisë e shërbimit të inspektimit gjyqësor në Shqipëri, që prej vitit 1912, sfida dukej gati e pakapërcyeshme.

Por me sa duket, ia dolëm. Sot, do hapim perden e kësaj pjese vitale dhe emocionuese të historisë sonë. Materialet që botohen në këtë libër përbëjnë një pjesë shumë të rëndësishme nga tradita institucionale e drejtësisë shqiptare. Besoj se janë materiale, pak të njohura për shumë prej nesh. Me përjashtim të studiuesve të veçantë për këtë fushë, komuniteti i juristëve të interesuar për zhvillimet e drejtësisë në Shqipëri, nuk e kanë patur mundësinë të njihen drejtpërdrejt me materialet që paraqitura në këtë libër nëpërmjet burimeve arkivore. Dhe ky botim sot, përpiqet të mbushë këtë boshllëk, duke ofruar një panoramë të qartë të zhvillimeve historike të shërbimit të inspektimit gjyqësor.

Ndodh, që edhe botimet e thjeshta me objekt temën historike, mund të ngjallin debat.

Por, me këtë botim, ne nuk kemi dashur të bëjmë asnjë interpretim apo koment mbi ngjarjet historike, që kanë shenjuar lindjen dhe zhvillimin e inspektimit gjyqësor. Ne kemi zgjedhur të paraqesim dokumentet në formën e tyre të pastër, ashtu sic dalin në burimet arkivore, me qëllimin e vetëm për të sjellë në dritë të vërtetën historike.

Por, dua ta theksoj fort nga ana tjetër, se është realisht emocionuese, të konstatosh ndërgjegjen e fortë shtetare, që në themelimin e shtetit shqiptar në 1912. Qeveria kombëtare e Vlorës, vendosi që krahas ngritjes së gjykatave e prokurorive të shtetit shqiptar, të krijonte edhe një inspektorat drejtësie, që të garantonte përgjegjshmërinë jo vetëm të sistemit, por edhe pavarësinë e tij, pasi inspektorët kishin edhe një kompetencë domethënëse, të verifikonin që administrata shtetërore të mos ndërhynte apo ndikonte në asnjë mënyrë, në veprimtarinë e gjykatave. Dua ta theksoj edhe njëherë, rëndësinë e ngritjes së inspektoratit të drejtësisë, të mbështetur në standardet e larta të ndarjes së pushteteve dhe të ruajtjes së pavarësisë së magjistratëve. Elita drejtuese e shtetit shqiptar të asaj kohe, tregon nëpërmjet ngritjes së institucioneve të shtetit shqiptar me këtë frymë kushtetueshmërie, se kishte kapacitete juridike të një klasi të lartë, për të cilët, shteti ka nevojë në çdo moment të jetës së vet. Ishin këto kapacitete juridike, që patën barrën, e ngritjes së arkitrarëve të godinës shtetërore shqiptare, që ia dolën të ndërtojnë ligjet më të rëndësishme e më të nevojshme për funksionimin e shtetit të sapongritur, i cili, sipas fjalëve të njërit prej përfaqësuesve të kësaj elite, Ahmet Zogu, të botuar në gazetën Dita e Re, në vitin 1922, duhej të qëndronte “me ftyrë nga Perëndimi”. E ky botim, është nderim edhe për përpjekjet të tyre, për ndërtimin e një drejtësie moderne dhe demokratike.

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË BULETINI MUJOR

Ndër përmirësimet që iu bënë më pas, deri kur vendi u shpall monarki, spikaste fokusi tek profesionalizmi i magistratëve, se kur një gjyqtari i prisheshin më shumë se gjysma e vendimeve nga një gjykatë më e lartë, apo kur më shumë se gjysma e vendimeve që kishte dhënë, nuk kishin mundësi ekzekutimi, atëherë Ministria e Drejtësisë vendoste marrjen e masës disiplinore të pushimit nga detyra.

Pas një kthimi mbrapa të shtetit të së drejtës në periudhën e monizmit, ku gjykatat e prokuroritë u njehsuan me partinë-shtet, pluralizmi riktheu në vëmendje rolin e gjyqësorit, si element kyç i shtetit të së drejtës, duke ligjëruar pavarësinë e gjyqtarëve e prokurorëve. Presidenti i Republikës si kryesues dhe më tej ministri i drejtësisë, me rol përherë e më të fortë, ishte modeli që Shqipëria provoi me përmirësimet deri në vitin 2016. Koha tregoi se nuk ishte mjaftueshëm për të patur një sistem të pavarur e garantues të shtetit të së drejtës, përderisa, me një konsensus të rrallë politik pozitë-opozitë, Kuvendi i Shqipërisë miratoi në korrik 2016 reformën në drejtësi, e cila riformatoi gjithë sistemin përmes një arkitekture të re, e cila si emërues të përbashkët kishte pavarësinë e gjyqtarëve e prokurorëve. Në këtë arkitekturë të re, procesi disiplinor vjen për herë të parë si kompetencë e një institucioni të vetëm, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, një institucion i pavarur kushtetues, që ka përgjegjësinë e inspektimit disiplinor për gjyqtarët e prokurorët e të gjitha niveleve. Zgjedhja në detyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë erdhi me përgjegjësinë e jashtëzakonshme, për përballjen me ngritjen e një institucioni të tillë me themele të forta profesionale, me pritshmëritë e publikut dhe aktorëve të tjerë politikë e institucionalë dhe me pritshmëritë e vetë sistemit të drejtësisë. Duke mos patur model paraardhës, vendosja e standardeve të tilla dhe mbi të gjitha, ruajtja e ekuilibrit mes pavarësisë së magistratëve dhe interesit krejt legjitim të publikut për mënyrën se si administrohet drejtësia, ishte dhe mbetet busulla orientuese e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Kjo mbetet sfida më e madhe profesionale dhe personale e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, jo për stabilitet institucional, por duke e parë këtë balancë interesash, si një parim kushtetues të rëndësishëm për të ardhmen e sistemit të drejtësisë dhe të shtetit të së drejtës. Natyrshëm si çdo proces, edhe testimi i kësaj filozofie pune, kërkon periudhën e vet të përballjes me sfidat që kalon sistemi dhe koha do të tregojë qëndrueshmërinë e zbatimit të saj në praktikë, si dhe efektet afatgjata në sistem.

Së fundmi, por jo nga rëndësia, do doja të bëja falenderimet shumë të merituar, të gjithkujt, që bëri të mundur këtë ditë sot. Dëshiroj të falenderoj inspektorin Periand Teta, ideja e të cilit për të parë shërbimin e inspektimit gjyqësor në vite, vuri në lëvizje të gjithë këtë proces pune.

Ekipin e ILD-së, që ka bërë një punë të shkëlqyer kërkimore, si në arkivin e shtetit ashtu edhe në bibliotekën kombëtare, edhe pse jo profesionistë të fushës së kërkimit. Për muaj e muaj të tërë, çdo ditë me këmbëngulje dhe pasion, kërkonin kudo, ku mund të kishte histori të shërbimit të inspektimit. Elis Kuçi, Zilie Feçi, Sidora Tyli, faleminderit, për të gjithë kontributin tuaj.

Erind Mërkuri, pedagogu këmbëngulës dhe pasionant par excellence i historisë të së drejtës dhe kushtetushmërisë, që investoi kohë, energji e përkushtim, pa asnjë interes financiar, por vetëm me pasionin e dashurisë për historinë, për të materializuar dokumentet arkivore në këtë botim. Këtu dua të falenderoj përzemërsisht misionin EU4Justice, që financoi botimin e këtij historiku, me një cilësi të shkëlqyer, e po vazhdon të na ndihmojë për ta sjellë edhe në gjuhën angleze.

Regjisorin Artan Rama, për dokumentarin e shkëlqyer, që na tregon protagonistët e inspektimit gjyqësor dhe të prokurorisë në kohë, me idealizimin, seriozitetin dhe profesionalizmin e tyre, për të zgjidhur çështjet e vështira që prodhonte koha. Dua të falenderoj një tjetër anëtar të ILD-së, Pavli Treskën, që bëri përkthimin në anglisht të dokumentarit, për audiencën e huaj.

Në krye të gjithë këtij procesi, për koordinimin e çdo hapi dhe çdo fazë të punës, për redaktimin profesional të këtij dokumentari e këtij botimi, për udhëheqjen e të gjithë procesit, nga dita 1 kur u diskutua për herë të parë kjo ide, e deri sa të dalë dhe njoftimi për shtyp i këtij aktiviteti, është Mimoza Koçi, njeriu që besoi fort tek realizimi i kësaj ideje dhe me sa duket kishte të drejtë.

Dhe tani, le të shohim dokumentarin “Të inspektosh drejtësinë”, e më pas vijojmë me folësit, sipas programit.

Mbrëmje të këndshme!



FOTO NGA AKTIVITETI



METANI: NJË DREJTËSI E FORTË DHE E QËNDRUESHME KËRKON ANGAZHIM TË VAZHDUESHËM



Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. Artur Metani mori pjesë në Mbledhjen e 3-të të Përbashkët të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë “Forcimi i Kapaciteteve Institucionale përmes Zhvillimit të Përmirësuar të Karrierës dhe Masave Mbrojtëse për Sistemin Gjyqësor”.

Në fjalën e tij, z. Metani e vuri theksin së pari tek praktikat që duhen ndjekur për të patur një sistem drejtësie të fortë e të qëndrueshëm. “Ndërtimi i një sistemi drejtësie të fortë dhe të qëndrueshëm kërkon angazhim të vazhdueshëm. Shteti i së drejtës nuk është thjesht një tërësi normash ligjore apo rregullash abstrakte, por është mbi të gjitha një veprimtari administrative institucionale. Në këtë kuadër, praktikat administrative të ndjekura nga ana e institucioneve tona duhet të kenë si qëllim ndërtimin e një mjedisi, ku meritokracia, pavarësia strukturore, siguria institucionale dhe profesionalizmi i magjistratëve të veprojnë si mekanizma të ndërruar nga njëri-tjetri”.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë u ndal edhe tek konstatimet e vërejtura gjatë veprimtarisë së punës së institucionit që drejton e që ndikojnë në cilësinë e punës e performancën e magjistratëve, e si të tilla duhen adresuar.

“Gjatë trajtimit të ankesave, apo zhvillimit të inspektimeve tematike/institucionale nga ana e institucionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është konstatuar se mungesa e ambienteve të përshtatshme dhe përdorimi i pamjaftueshëm i teknologjisë së informacionit, përfshirë regjistrimin audio të seancave, sistemet e menaxhimit të çështjeve, arkivat, qarkullimin e dokumentacionit procedural dhe administrativ, si dhe sistemet teknologjike që mbulojnë procese specifike të punës së gjykatës apo prokurorisë, ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë dhe solemnitetin e gjykimit, si dhe në zhvillimin e hetimeve penale. Në disa raste, këto kushte kanë ndikuar edhe në sjelljen etiko-profesionale të magjistratëve, duke ekspozuar sistemin e drejtësisë ndaj perceptimeve negative nga publiku.

Modernizimi i infrastrukturës, rishikimi i protokolleve të sigurisë, vendosja e mekanizmave mbikëqyrëse dhe zhvillimi i analizave për menaxhimin e riskut dhe adoptimi i praktikave bashkëkohore të sigurisë së sistemeve dhe teknologjisë së informacionit janë masa thelbësore që garantojnë një mjedis pune të sigurt dhe funksional për të gjithë magjistratët. Për këtë arsye, investimi në infrastrukturë dhe për sigurinë e magjistratëve duhet të konsiderohet pjesë integrale e politikave për forcimin e pavarësisë, legjitimitetit dhe integritetit të pushtetit gjyqësor. Vetëm në këtë mënyrë pushteti gjyqësor mund të funksionojë në mënyrë të qëndrueshme, duke garantuar cilësi, integritet dhe besueshmëri në çdo nivel të veprimtarisë së tij”.

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË BULETINI MUJOR

FJALA E PLOTË E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË Z. ARTUR METANI

Të nderuar kryetarë të Këshillave,

I nderuar Kryetar i Gjykatës së Lartë,

I nderuar Prokuror i Përgjithshëm,

I nderuar z. Dobi,

Të nderuar shkëlqesi ambasadorë dhe partnerë,

Të nderuar të ftuar!

Faleminderit për ftesën dhe mundësinë për të ndarë disa reflektime në kuadër të këtij takimi të tretë të përbashkët të institucioneve tona. Tematikat që do të trajtojmë sot si vlerësimi etik dhe profesional i magjistratëve, ndikimi i tij në zhvillimin e karrierës, si dhe siguria dhe infrastruktura e ambienteve të gjykatave dhe zyrave të prokurorisë, janë çështje me një rëndësi të veçantë, pasi këto çështje nuk përfaqësojnë vetëm prioritet të institucioneve tona në ushtrimin e kompetencave ligjore, por janë gjithashtu themelore për garantimin e cilësisë së drejtësisë dhe respektimin e standardeve të shtetit të së drejtës. Sot, ky takim është mundësia jonë për të diskutuar dhe konsoliduar praktikatat që mbështesin integritetin, pavarësinë dhe legjitimitetin e pushtetit tonë gjyqësor.

Kontributi i EU4Justice dhe Bashkimit European mbetet i domosdoshëm për implementimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të reformës në drejtësi në Shqipëri,

ku asistencat teknike e ofruar përkthehet në rritje të kapaciteteve dhe cilësisë së vendimarrjes. Megjithatë, rolin kryesor dhe të qënësishëm duhet ta luajnë institucionet tona, të cilat duhet të marrin vendime dhe ku debati profesional duhet shoqërohet me një analizë të mirëfilltë në nivel sistematik dhe planifikimi strategjik.

Ndërtimi i një sistemi drejtësie të fortë dhe të qëndrueshëm kërkon angazhim të vazhdueshëm. Shteti i së drejtës nuk është thjesht një tërësi normash ligjore apo rregullash abstrakte, por është mbi të gjitha një veprimtari administrative institucionale. Në këtë kuadër, praktikatat administrative të ndjekura nga ana e institucioneve tona duhet të kenë si qëllim ndërtimin e një mjedisi ku meritokracia, pavarësia strukturore, siguria institucionale dhe profesionalizmi i magjistratëve të veprojnë si mekanizma të ndërruar nga njëri-tjetri.

Vlerësimi etik dhe profesional i magjistratëve është një gur themeli mbi të cilin ndërtohet besimi i publikut në sistemin e drejtësisë. Ai nuk është thjesht një proces formal administrativ, por është një mekanizëm i rëndësishëm që garanton ex-ante integritetin dhe zhvillimin profesional të magjistratëve. Ky proces duhet të jetë i parashikueshëm, i qartë, i paanshëm dhe transparent. I mbështetur në indikatorë apo tregues të qartë dhe të matshëm, si dhe duke shmangur çdo aspekt subjektivizmi, apo ndikimi të jashtëm. Në praktikë, kjo do të thotë krijimin e një sistemi vlerësimi etiko-profesional që monitoron dhe vlerëson performancën e magjistratëve jo vetëm në bazë të rezultateve të punës, por edhe në përputhje me standardet morale, etike dhe profesionale. Një qasje e tillë siguron jo vetëm integritetin individual të magjistratëve, por edhe besueshmërinë e publikut në sistemin e drejtësisë në tërësi.



INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË BULETINI MUJOR

Një çështje që kërkon vëmendje të veçantë është gjithashtu dhe infrastruktura e pushtetit gjyqësor. Ndërkohë, në kushtet e rritjes së kompleksitetit të çështjeve gjyqësore dhe ekspozimit publik të pushtetit gjyqësor, edhe siguria personale e magjistratëve nuk mund të konsiderohet vetëm një çështje administrative, por ajo është një parakusht themelor për funksionimin e paanshëm dhe të pavarur të pushtetit gjyqësor. Në këtë drejtim, sistemi i vlerësimit etiko-profesional të magjistratëve dhe siguria apo infrastruktura janë procese të ndërruar nga njëri-tjetri. Një magjistrat nuk mund të vlerësohet objektivisht në lidhje me integritetin e tij, apo cilësitë e tij profesionale në mungesë të sigurisë së tij personale, apo kushteve të mjaftueshme infrastrukturore. Në këtë aspekt, vlen të theksohet se mungesa e këtyre elementëve të rëndësishëm rrit mundësinë e gabimeve njerëzore, të ndikimeve të jashtme, ose të shkeljeve të etikës profesionale nga ana e magjistratëve.

Gjatë trajtimit të ankesave, apo zhvillimit të inspektimeve tematike/institucionale nga ana e institucionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është konstatuar se mungesa e ambienteve të përshtatshme dhe përdorimi i pamjaftueshëm i teknologjisë së informacionit, përfshirë regjistrimin audio të seancave, sistemet e menaxhimit të çështjeve, arkivat, qarkullimin e dokumentacionit procedural dhe administrativ, si dhe sistemet teknologjike që mbulojnë procese specifike të punës së gjykatës apo prokurorisë, ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë dhe solemnitetin e gjykimit, si dhe në zhvillimin e hetimeve penale. Në disa raste, këto kushte kanë ndikuar edhe në sjelljen etiko-profesionale të magjistratëve, duke ekspozuar sistemin e drejtësisë ndaj perceptimeve negative nga publiku.

Modernizimi i infrastrukturës, rishikimi i protokolleve të sigurisë, vendosja e mekanizmave mbikëqyrëse dhe zhvillimi i analizave për menaxhimin e riskut dhe adoptimi i praktikave bashkëkohore të sigurisë së sistemeve dhe teknologjisë së informacionit janë masa thelbësore që garantojnë një mjedis pune të sigurt dhe funksional për të gjithë magjistratët. Për këtë arsye, investimi në infrastrukturë dhe për sigurinë e magjistratëve duhet të konsiderohet pjesë integrale e politikave për forcimin e pavarësisë, legjitimitetit dhe integritetit të pushtetit gjyqësor. Vetëm në këtë mënyrë pushteti gjyqësor mund të funksionojë në mënyrë të qëndrueshme, duke garantuar cilësi, integritet dhe besueshmëri në çdo nivel të veprimtarisë së tij.

Për sa më sipër, personalisht vlerësoj se rezultatet e pritshme të këtij takimi nuk duhet të mbeten thjesht në nivel rekomandimesh. Ato duhet të shndërrohen në standarde të qarta dhe drejtpërdrejt të zbatueshme për vlerësimin etik dhe profesional të magjistratëve; mekanizma të qartë ligjorë për monitorimin dhe përmirësimin e karrierës së tyre; si dhe masa apo vendime konkrete për sigurinë dhe infrastrukturën e gjykatave dhe prokurorisë. Vetëm përmes një qasjeje të koordinuar dhe bashkëpunimi ndërinsitucional, vizioni afatgjatë, planifikimi të mirë strategjik dhe buxhetor, si dhe duke integruar praktikën më të mira të Bashkimit Europian apo të Këshillit të Evropës mund të ndërtojmë një sistem drejtësie të pavarur, me integritet dhe sa më profesional.

Faleminderit!



INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË, VIZITË PUNE NË HUNGARI



Budapest, 2 dhjetor 2025

Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. Artur Metani, i shoqëruar nga ekipi i inspektorëve të ILD-së zhvilloi një vizitë pune në institucione të drejtësisë në Budapest, konkretisht në Zyrën Kombëtare për Gjyqësorin dhe në Prokurorinë e Përgjithshme.

Gjatë takimeve, delegacioni shqiptar u shoqërua nga ambasadori i Shqipërisë në Hungari, z. Ilirian Kuka, që u kujdes për mbarrëvajtjen e vizitës, e cila synoi vendosjen dhe forcimin e marrëdhënieve ndërinstitucionale, shkëmbimin e eksperiencave dhe praktikave të punës në kuadër të realizimit të procedurave të inspektimit dhe hetimit disiplinor ndaj gjyqtarëve e prokurorëve, me synim krijimin e mundësive për bashkëpunim institucional për procedurat disiplinore ndaj magjistratëve në Republikën e Hungarisë.

Në takimet me drejtuesin e Zyrës Kombëtare për Gjyqësorin, z. György Senyei, por edhe me drejtues në Prokurorinë e Përgjithshme të Hungarisë, pas paraqitjes së organizmit dhe funksionimit të strukturave, të lidhura me përgjegjësinë disiplinore të prokurorëve,

bashkëbisedimi vijoi në nivel konkret me shkëmbim informacioni dhe përvojash në lidhje me aspektet procedurale të realizimit të hetimit disiplinor, si zhvillimi i metodave të hetimit disiplinor lidhur me shkeljet disiplinore të magjistratëve, teknikat e avancuara të intervistimit të tyre, sigurimin dhe trajtimin e informacionit nga institucionet e tjera ligj zbatuese, analizën e dokumentacionit të grumbulluar gjatë procedurës së verifikimit apo hetimit, hartimit të raportit të hetimit, grumbullimin e provave.

Ekipi i ILD-së dhe drejtues të institucioneve të drejtësisë të Hungarisë veçuan eksperiencat respektive mbi metodologjinë e kryerjes së inspektimeve dhe standardizimin e procedurave të inspektimit; mbi praktikën dhe standardet më të larta të integritetit dhe sjelljes etike të prokurorëve dhe mbi mënyrën e komunikimit me publikun me qëllim sigurimin e balancës ndërmjet parimit të drejtësisë së hapur dhe parimit të konfidencialitetit, mbrojtjes së të dhënave personale dhe integritetit të prokurorëve.



ILD MORI PJESË NË ASAMBLENË E PËRGJITHSHME TË RESIJ



Paris 12.12.2025

Rrjeti Evropian të Shërbimeve të Inspektimit të Drejtësisë (RESIJ), ku Inspektori i Lartë i Drejtësisë është anëtar, zhvilloi Asamblenë e Përgjithshme organizative dhe vendimmarrëse. Eventi u organizua nga Presidenca e RESIJ dhe u mbajt në Gjykatën e Apelit në Paris.

Anëtarët e RESIJ bënë një përmbledhje të situatës administrative të rrjetit, detyrimet, punën e tremujorit të fundit të vitit 2025 dhe u votua programin për gjashtë muajt e ardhshëm.

Gjatë Asamblesë u përcollën të reja nga përdorimi i Inteligjencës Artificiale në drejtësi nga disa vende dhe përparimi i Italisë, që ka miratuar një ligj për përdorimin e IA në shtator të vitit 2025.

Asambleja e RESIJ zyrtarizoi pranimin e Moldavisë, si anëtarja më e re e RESIJ dhe rikonfirmoi për një mandat të dytë 2-vjeçar në bordin ekzekutiv të rrjetit Spanjën, Portugalinë dhe Italinë.



DHJETORI I ILD NË SHIFRA

Gjatë muajit dhjetor 2025 Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka administruar 143 ankesa, nga ta cilat 140 ankesa të depozituara nga qytetarë dhe 3 nga institucione. Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka kryer konfirmimin standard të marrjes së ankesës për të gjitha ankesat, që kanë hyrë për herë të parë në institucion gjatë muajit dhjetor 2025.

Ankesat që kanë subjekt të tyre prokurorë dhe gjyqtarë janë shpërndarë tek Inspektorët. Ato ndodhen në faza të ndryshme trajtimi, si shqyrtim fillestar, arkivim, verifikim, me projektvendimet përkatëse.

ARKIVIME	VERIFIKIME	PROCESI DISIPLINOR
141 vendime nga 276 praktika të trajtuara: · 121 vendime arkivimi pas shqyrtimit fillestar · 20 vendime arkivimi pas verifikimit	36 vendime	2 vendime për mbyllje hetimi disiplinor për 2 magjistratë (1 gjyqtar, 1 prokuror)

ANKIMI NË ILD

Për të lehtësuar procesin e ankimit për personat e interesuar, ILD ka të publikuar në faqen zyrtare një formular të posacëm ankesë, i cili:

- mund të plotësohet direkt dhe dërgohet online;
- të shkarkohet, plotësohet e dërgohet me email në info@ild.al ose me postë në adresën Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Godina nr. 13, Tiranë;
- mund të plotësohet pranë Zyrës së ILD, në rast nevojë, me asistencën e ekipit të zyrës së ankesave.

Pas marrjes së ankesës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë Brenda 5 ditëve konfirmon me shkresë marrjen e saj.

Kriteret e pranueshmërisë së ankesës gjenden të publikuara në faqen zyrtare të ILD www.ild.al, në seksionin “Si pranohen ankesat”.

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË BULETINI MUJOR



Gjatë asistimit të ankuesve

Ekipi i zyrës së ankesave pret qytetarë-ankues çdo ditë pune nga ora 09.00 - 14.00, ndërsa për një komunikim të shtuar me qytetarët e interesuar, krahas komunikimit përmes faqes dhe adresës zyrtare.

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka vënë në dispozicion numrin e telefonit +355 4 2217217.
Pjesë e ekipit është edhe Koordinatori për të drejtën e informimit.



SHPLLJE PUBLIKE E VENDIMEVE

Edhe gjatë muajit Dhjetor Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ka bërë shpalljen publike të vendimeve të arkivimit, për **7 ankues**, të cilët kanë rezultuar të paarrtshëm në adresat e komunikuar prej tyre. Përveçse në stendat e ILD-së, sipas ligjit këto shpallje gjenden edhe në faqen tonë zyrtare dhe të afishuara edhe në stendat e bashkive nga vijnë ankuesit.



KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Në përputhje me parimet dhe rregullat e parashikuara në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, koordinatori për të drejtën e informimit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i mundëson çdo kërkuar të drejtën për t’u njohur me informacionin publik, si dhe komunikon sipas nevojës me kërkuar për trajtimin e kërkesës për informacion publik.

Kërkesa për informacion depozitohen nga qytetarët, personat juridikë, grupet e

interesuara, nëpërmjet Postës Shqiptare Sh.a., postës elektronike në adresën: info@ild.al, si dhe asaj të koordinorit për të drejtën e informimit amanta.jasa@ild.al.

Informacionet e parashikuara në programin e transparencës publikohen dhe përditësohen në mënyrë të vazhdueshme në regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve, brenda afatit të parashikuar ligjor.

*Gjatë muajit **Dhjetor 2025**, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kanë mbërritur **14 kërkesa** për informacion, të cilat janë trajtuar në të gjitha rastet brenda 5 ditëve, (ligji parashikon që kërkuar t’i kthehet përgjigje brenda 10 ditëve).*

ILD NË TWITTER

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur...
@ILD_Albania

Praktikat administrative të ndjekura nga institucionet tona duhet të synojnë ndërtimin e një mjedisi ku meritokracia, pavarësia strukturore, siguria institucionale & profesionalizmi i magistratëve të veprojnë si mekanizma të ndërvlarur nga njëri-tjetri. 📌



From ild.al

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur...
@ILD_Albania

Metani: Inspektimi gjyqësor mbetet shpesh në hije dhe vëmendjen publike e marrin natyrshëm vendimet gjyqësore. Por, inspektimi gjyqësor mbetet një mjet shumë i rëndësishëm për ruajtjen e integritetit të sistemit të drejtësisë. #ILD #ArturMetani #fjala 📌



From ild.al


Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur...
@ILD_Albania

📍 Përpunimi javor i ankesave në #ILD 📌

- ✅ 8484 të konfirmuara
- ✅ 6470 të trajtuara
- ✅ 2014 në proces trajtimi
- ✅ 129 në proces verifikimi
- ✅ 144 magistratë të hetuar
- ✅ 53 kërkesa për procedim disiplinor

? Keni pasur eksperiencë me ne? Na thoni 📌

ild.al/sq/ankete/



This information is updated every monday

Thematic and Institutional Inspections

TOTAL INSPECTIONS: 21 COMPLETED INSPECTIONS: 15

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur...
@ILD_Albania

Një dokumentar për të nderuar punën e gjithkujt ka kontribuar ndër vite në inspektimin e drejtësisë. Një punë jo e lehtë, shpesh e paragjykuar, por me rëndësi të vecantë për ruajtjen e integritetit të sistemit të drejtësisë. #Tëinspektoshdrejtësinë #ILD

YouTube



Dokumentar - Të inspektosh drejtësinë

Enjoy the videos and music you love, upload original content, and share it all with friends, family, and the world on YouTube.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur...
@ILD_Albania

Falenderime të gjithëve për pjesëmarrjen për të ndarë së bashku vlerësimin për kontribuesit ndër vite të inspektimit të drejtësisë. #ILD #inspektimidisiplinor #magjistratë 📌

ild.al/sq/2025/12/09/...




Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur...
@ILD_Albania

📍 Përpunimi javor i ankesave në #ILD 📌

- ✅ 8495 të konfirmuara
- ✅ 6483 të trajtuara
- ✅ 2012 në proces trajtimi
- ✅ 131 në proces verifikimi
- ✅ 144 magistratë të hetuar
- ✅ 53 kërkesa për procedim disiplinor

? Keni pasur eksperiencë me ne? Na thoni 📌

ild.al/sq/ankete/



This information is updated every monday

Thematic and Institutional Inspections

TOTAL INSPECTIONS: 21 COMPLETED INSPECTIONS: 15

DHJETOR 2025


Të gjitha të drejtat e rezervuara
© ILD



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

KONTAKT

WEB: ild.al
TEL: +35542217217
EMAIL: info@ild.al
ADRESA: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”,
Godina nr. 13, Tiranë, Shqipëri



Spot prezantues ILD
Prezantimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë
[youtube.com](https://www.youtube.com)



Më skano!